



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1194/1 prot.

Tiranë, më 13. 08. 2025

V E N D I M

Nr. 196, datë 13. 08. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 178 Regj., datë 06.08.2025, të shtetasit Z. K., kundër Spitalit Rajonal Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, Z. K., ai parashtron ndër të tjera se: “*Kam 18 vite që jam duke u përballur me probleme të shumta shëndetësore, disa prej tyre të shkaktuara nga ndërhyrjet mjekësore të stafit të Spitalit Rajonal, Shkodër. Në vitin 2007, kam kryer një ndërhyrje kirurgjikale në kanalën urinar dhe më pas qëndrova për 16 ditë në shtëpi. Kur shkova të heq kateterin, pata disa komplikacione (gjakderdhje) nga mos kujdesja e stafit infermieror dhe nga neglizhenca e doktorit, gjë që solli përkeqësimin e gjendjes time shëndetësore. Për 6 muajt në vijim, pata dhimbje të vazhdueshme, në atë pikë që as ilaçet qetësuese nuk patën ndonjë efekt. Ndërkohë gjatë kësaj kohe, mjeku G. G. nuk më trajtoi siç duhej dhe më shmangte vazhdimisht duke vepruar në kundërshtim të plotë me detyrimet që ka si doktor dhe duke më bërë të ndihem i neglizhuar. Doktorin në fjalë, më dha disa kokrra për të më qetësuar dhimbjet të cilat i bleva me lekët e mija por që dolën që nuk kishin ndonjë rezultat. Këtë rast ia referova dhe drejtorit të spitalit, asokohe, N. K., por edhe ai në mënyrë indiferente më tha që të shkoja në shtëpi se do të më kalonte dhimbja. Për vite të tëra kam vuajtur nga depresioni dhe nga dhimbjet e shumta trupore.*

Në vitin 2023, pasi simptomat vazhduan, iu drejtova mjekut B. Sh., i cili realizoi një ndërhyrje të dytë. Pavarësisht ndërhyrjes, dhimbjet që kisha nuk u larguan dhe analizat e bëra më pas të cilat m'i kishin referuar mjekët, tregonin që çdo gjë ishte në rregull por që përsëri nuk shpjegonin simptomat që kisha. Për pasojë, u përkeqësua gjendja ime psikologjike, me pasojë neurologjike të dokumentuara si: çrregullim të ekuilibrit, depresion dhe rrëzime.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Pavarësisht përpjekjeve për të denoncuar këtë situatë pranë organeve kompetente, përfshirë prokurorinë, nuk kam marrë asnjë përgjigje dhe nuk jam kontaktuar për depozitimin e kallëzimit. Unë kohët e fundit kontaktova me oficerin e policisë gjyqësore për të lënë një takim dhe për ti dërguar dokumentet dorazi në përputhje me deklaratimet e bëra disa ditë më përpara tek OPGJ. Kanë kaluar 3 muaj që nga ai takim dhe nuk më kanë kontaktuar akoma. Unë kërkoj që vihen përpara përgjegjësisë, personat që janë përfshirë në trajtimin tim mjekësor.”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit të tij, për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore, nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Subjekti ankues, ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit, duke pretenduar diskriminim për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore, nga ana e mjekëve të Spitalit Rajonal Shkodër. Në objektin e ankesës, Z. K. ka pretenduar ndër të tjera se është neglizhuar dhe nuk ka marrë trajtimin e duhur mjekësor nga ana e mjekëve të Spitalit Rajonal Shkodër. Sakaq, ai ka depozituar edhe kallëzim penal ndaj mjekëve, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- *Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gjerat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;” Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:*

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit se është neglizhuar dhe nuk ka marrë trajtimin e duhur mjekësor nga ana e mjekëve të Spitalit Rajonal Shkodër.*

Ligji nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 21 ka parashikuar “Standardet e përgjithshme për institucionet e kujdesit shëndetësor”, ku në përmbajtje të tij përcaktohet se: “1. Ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet që, gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të veprojnë në përputhje me standardet profesionale dhe etike, të përcaktuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe urdhrat e profesionistëve.

2. Ministri i Shëndetësisë, me urdhër, miraton normat dhe standardet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

3. Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregulloret lidhur me llojet dhe nivelin e shërbimeve të institucioneve të kujdesit shëndetësor.”

Ndërsa neni 21, i ligjit sipërcituar parashikon se: “1. Cilësia dhe siguria e kujdesit shëndetësor në përputhje me standardet është detyrim profesional dhe etik i kujdesit shëndetësor.

2. Të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor krijojnë programet dhe mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e strategjisë kombëtare të cilësisë, të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë.

3. Qëllimi i menaxhimit të cilësisë është të masë, të vlerësojë dhe të përmirësojë ofrimin e kujdesit të pacientit, si dhe të zhvillojë e të implementojë programe efikase të menaxhimit të sëmundjes, protokolleve klinike dhe udhëzuesve mjekësorë.”

Ligji Nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton rregullat e organizimit dhe të veprimtarisë, sa i përket ruajtjes së standardeve, ushtrimit të profesioneve në fushën e mjekësisë, mbrojtjes së pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut. Sakaq, në nenin 16 “Komisionet disiplinore”, të tij është përcaktuar se:

“1. Pranë këshillave rajonale dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë komisionet disiplinore si organizma të gjykimit profesional. Komisioni disiplinor rajonal përbëhet nga 9 anëtarë të

zgjedhur nga Këshilli Rajonal. Komisioni Disiplinor Kombëtar përbëhet nga 15 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

2. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

3. Komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonalë, ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve disiplinore përcaktohet në statutin dhe në rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit”.

Ndërsa neni 17, parashikon masat disiplinore, duke përcaktuar se: “1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara dhe seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit Etik dhe Deontologjik ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore publike dhe private.

d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Mjekëve deri në 3 vjet.

dh) përjashtim nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet.

2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si masë plotësuese, komisioni ka të drejtë t’u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite.

3. Masat disiplinore, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore:

i) brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni;

ii) brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “ç”, “d” e “dh”, të pikës 1, të këtij neni.

4. Gjoka e vendosur sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, derdhet në Buxhetin e Shtetit”.

Neni 19, i jep një sqarim më të hollësishëm sa i përket Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, duke theksuar se: “1. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore është dokumenti themelor i profesionit mjekësor, në të cilin materializohen të gjithë parimet dhe standardet profesionale të detyrueshme për t’u njohur e zbatuar nga çdo anëtar i Urdhrit në praktikën mjekësore, si edhe nga çdo institucion shëndetësor.

2. Këshilli Kombëtar harton dhe miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore”.

Në nenin 1, të Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional, të miratuar me Vendimin nr.1, datë 08.04.2016 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, të ndryshuar, përcaktohet se:

“Gjykimi Disiplinor Profesional dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional janë bazuar në ligjin nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe në Statutin e UMSH-së.

Mbështetur në këto akte normative, UMSH ndërmerr veprime dhe bën gjykimin disiplinor profesional të anëtarit të vet, në rastet kur: ...e) Veprimet dhe sjellja e tij përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe legjislacionit në fuqi”.

Në nenin 68 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, përcaktohet se: *“Çdo akt mjekësor, apo sjellje profesionale në kundravajtje me dispozitat e këtij Kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në Ligjin 8615, date 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Mjekëve”.*

Pra, referuar legjislacionit sipërcituar, Komisioneri vlerëson se organi që ka kompetencën kryesore për vlerësimin *profesional dhe etik* të mjekëve janë Komisionet Disiplinore të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, në Neni 96 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: *“Mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose e personelit tjetër mjekësor, si dhe moszbatimi i terapisë ose i porositve të mjekut nga personeli mjekësor apo farmacist, kur ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, ka rrezikuar jetën e personit ose ka shkaktuar vdekjen e tij, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me infeksionin HIV/AIDS, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet”.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues që, bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009 *“Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, në ligjin nr. 123/2014 *“Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”*, dhe në Rregulloren për Gjykimin Disiplinor Profesional; nëse ka pretendime lidhur me trajtimin e gabuar apo të pakujdesshëm shëndetësor, mund t’i drejtohet me ankesë Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe/ose me kallëzim organeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet, nëse..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 1, 4/b të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues Z. K., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Mosha dhe gjendja shëndetësore)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)